

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush është Konstantin Kosachev, rusi që inicioi mocionin që çoi te raporti i Dick Marty-t për Gjykatën Speciale
ADRESA	https://tpz.al/kush-eshte-konstantin-kosachev-rusi-qe-inicioi-mocionin-qe-coi-te-raporti-i-dick-marty-t-per-gjykatën-speciale-i333448
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 14:41:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 14:26:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	20dc876dc7b112f7f983974bcf19af85dd7a11d06365eb1c2504c046f07f035f
TEKSTI	57216be42a9a7b7cd352b2148e9e47939ae71f23bd0c59c47066f5463b3c736b
PAMJA	9dd35446a5fad01f548e503ccf1c89a243253bf60b79c4e8f0ab92930ffff6832

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	92620686948cdd8786b57935da89147519e46eba8c828a937d99cf5955762ac0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ac48a4064545432ea373f4e7d0b56014d8dcbe9272af7bcd7f9339adcddebee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/92620686948cdd8786b57935da89147519e46eba8c828a937d99cf5955762ac0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

16:23 Zjarr masiv në landfillin e Fushë-Krujës, tymi i dendur përhapet drejt Kamzës e Mamurrasit • 15:20 Ngjarje e rëndë në Dibër, një 22-vjeçarë mbytet në lumin Drini i Zi

BALLKAN, 20 SEPTEMBER 2026, 16:26

Kush është Konstantin Kosachev, rusi që inicioi mocionin që çoi te raporti i Dick Marty-t për Gjykatën Speciale

tpz.al TPZ



Historia e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë mund të gjurmohet më shumë se shtatë vjet para se Kuvendi i Kosovës të miratonte bazën kushtetuese për krijimin e tyre.

Pika e parë e dokumentuar e këtij procesi gjendet në Strasburg, më 15 prill 2008, kur politiani rus Konstantin Kosachev, atëherë deputet i Dumës së Shtetit dhe anëtar i delegacionit rus në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, paraqiti së bashku me 16 parlamentarë të tjerë një mocion me titull "Inhumane treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo".

Dokumenti, i regjistruar në PACE si Dokumenti 11574, kishte në qendër pretendimet për trajtim çnjerëzor dhe trafikim të paligjshëm të organeve në Kosovë. Në tekstin e mocionit përmendeshin pretendimet e publikuara në kujtimet e Carla Del Ponte, ish-kryeprokurores së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

Mocioni i Kosachev-it dhe parlamentarëve të tjerë nuk ishte aktakuzë dhe nuk përbënte një konstatim gjyqësor. Vetë dokumenti i PACE-s sqaron se mocioni nuk ishte diskutuar nga Asambleja dhe se angazhonte vetëm parlamentarët që e kishin nënshkruar.

Por dokumenti kishte një rëndësi tjetër, ai e futi çështjen në procedurën institucionale të Këshillit të Evropës. Më 29 maj 2008, mocioni u referua te Komiteti për Çështjet Juridike dhe të Drejtat e Njeriut të PACE-s për përgatitjen e një raporti. Më 25 qershor 2008, komiteti caktoi senatorin zviceran Dick Marty si raportues për çështjen. Dokumentet zyrtare të PACE-s e lidhin raportin e Marty-t drejtpërdrejt me mocionin 11574 të paraqitur nga Kosachev dhe 16 parlamentarë të tjerë.

Kështu nisi një zinxhir institucional që do të zgjaste për vite: mocioni i Kosachev-it, emërimi i Marty-t, raporti i tij, hetimi i Bashkimit Evropian dhe, më pas, krijimi i Dhomave të Specializuara. Më 7 janar 2011, Dick Marty paraqiti raportin "Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo". Raporti trajtonte pretendime për vende të fshehta ndalimi nën kontrollin e UÇK-së në veri të Shqipërisë dhe pretendime se disa të

ide!

Disa sugjerime pas Aktgjykimit të 16 shtatorit
Nga Veton Surroi

Rikthimi i koordinimit me Quintin për ruajtjen e shtetit të Kosovës
Albert Prenkaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

burgosur ishin vrarë për t'u nxjerrë organet, të cilat më pas do të trafikoheshin.

[Shiko të tjera video](#)

Raporti u bë një nga dokumentet kryesore mbi të cilat u mbështet procesi i mëvonshëm hetimor. Më 25 janar 2011, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi Rezolutën 1782, "Investigation of allegations of inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo", me 169 vota pro, tetë kundër dhe 14 abstenime.

Në këtë pikë, pretendimet për trafikim organesh nuk ishin më vetëm pjesë e një mocioni të parlamentarëve, ato ishin bërë objekt i një raporti zyrtar të Këshillit të Evropës dhe i një rezolute të Asamblesë. Në shtator 2011, Bashkimi Evropian krijoi Task Forcën Speciale Hetimore – SITF – për të zhvilluar një hetim penal të pavarur mbi pretendimet e raportit të Marty-t dhe krimet e lidhura me to. Vetë Dhomat e Specializuara, në përshkrimin e historikut të tyre, e lidhin krijimin e SITF-së me raportin e Këshillit të Evropës dhe thonë se hetimi i saj çoi në përfundimin se kishte prova të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzave.

Në krye të SITF-së ishte prokurori amerikan Clint Williamson. Pas rreth tre vjetësh hetime, më 29 korrik 2014, Williamson prezantoi përfundimet e punës së Task Forcës në Bruksel.

Williamson deklaroi se hetimi kishte gjetur prova të mjaftueshme për të proceduar penalisht disa ish-zyrtarë të lartë të UÇK-së për një sërë krimesh, përfshirë vrasje, rrëmbime, ndalime dhe dhunë seksuale. Ai tha se këto krime nuk dukeshin si veprime të izoluara të individëve, por si një fushatë e organizuar përndjekjeje.

Por pikërisht te trafikimi i organeve, hetimi solli një përfundim që ndryshonte nga mënyra se si pretendimi ishte paraqitur në debatin publik. Williamson tha se kishte "indikacione bindëse" se praktika e nxjerrjes dhe trafikimit të organeve kishte ndodhur në një shkallë shumë të kufizuar dhe se një numër i vogël njerëzish ishin vrarë për këtë qëllim. Ai, megjithatë, tha se në atë fazë nuk kishte prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzë për këtë vepër.

Pra, hetimi i SITF-së nuk e shndërroi pretendimin për trafikim organesh në një aktakuzë penale.

Ky është një nga dallimet më të rëndësishme mes raportit të Marty-t dhe hetimit të Williamson-it. Raporti i Këshillit të Evropës kishte vendosur pretendimet për trafikim organesh në qendër të vëmendjes ndërkombëtare, ndërsa hetimi penal disa vite më vonë tha se kishte indikacione për një praktikë shumë të kufizuar, por se nuk kishte prova të mjaftueshme për ndjekje penale për këtë vepër.

Ndërkohë, Williamson kërkoi që për veprat e tjera për të cilat kishte prova të mjaftueshme të krijohej një mekanizëm i përshtatshëm gjyqësor. Dhomat e Specializuara do të ishin pikërisht mekanizmi që do të merrej me këto akuza.

Në vitin 2014, Kosova dhe Bashkimi Evropian ndërmorën hapat institucionalë për krijimin e këtij mekanizmi. Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimin kushtetues që shtoi nënin 162 të Kushtetutës dhe miratoi Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Vetë Dhomat e Specializuara thonë se kjo u bë pas marrëveshjes së vitit 2014 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Kështu, një mocion i paraqitur në Strasburg në vitin 2008 u shndërrua, përmes disa hallkave institucionale, në një proces që përfundoi me krijimin e një institucioni të posaçëm gjyqësor në Hagë.

Por historia e trafikimit të organeve nuk përfundoi me krijimin e Gjykatës Speciale. Në vitin 2020, Prokuroria e Specializuar ngriti aktakuzën ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Aktakuza u konfirmua më 26 tetor 2020 dhe u bë publike në nëntor të atij viti.

Në versionin e aktakuzës së konfirmuar, akuzat përfshinin gjashtë pika për krime kundër njerëzimit – përndjekje, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje dhe zhdukje të detyruar si dhe katër pika për krime lufte: arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje.

Trafikimi i organeve nuk ishte pjese e ketyre akuzave. Kjo eshte pika ku ndarja mes historise se procesit dhe përmbajtjes së aktakuzës bëhet thelbësore.

Pretendimet për trafikim organesh ishin në titullin dhe në thelbin e mocionit të paraqitur nga Kosachev në vitin 2008. Ato ishin në qendër të raportit të Marty-t në vitin 2011. Ato u hetuan më pas nga SITF-ja. Williamson tha në vitin 2014 se kishte indikacione bindëse për një praktikë të kufizuar, por se nuk kishte prova të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzës për këtë vepër.

Ndërsa aktakuza e Dhomave të Specializuara ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit u përqendrua në vepra të tjera penale. Edhe sot, vetë Dhomat e Specializuara e përshkruajnë juridiksionin e tyre si të lidhur me krimet dhe pretendimet e raportuara në raportin e Këshillit të Evropës të 7 janarit 2011.

Dhe në vitin 2020, aktakuza ndaj katër ish-drejtimesve të UÇK-së nuk përfshiu trafikimin e organeve si vepër penale.

Më 16 shtator 2026, në përfundim të gjykimit, Trupi Gjykues i Dhomave të Specializuara i shpalli Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin.

Thaçi dhe Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 vjet dhe Selimi me 13 vjet.

Tani, sipas avokatëve çështja do të kalojë në Apel, dhe aty mund të konfrontohet vendimi i shkallës së parë me provat e mbrojtjes./Telegrafi/

BALLKAN / 20 September 2026, 15:14

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, kryeministri Kurti: Duhet koordinim shtetëror dhe diplomatik për të ndryshuar vendimin

BALLKAN / 20 September 2026, 12:20

Pas 27 vitesh, identifikohet Idriz Rrecaj, një nga 23 viktimat e "Grupit të Intelektualëve" në Kosovë

BALLKAN / 19 September 2026, 22:59

Mbrojtja përgatit Apelin ndaj aktgjykimit të krerëve të UÇK-së, rasti Gotovina ngjall shpresë

BALLKAN / 19 September 2026, 22:47

Kurti në New York: Qeveria do të angazhohet për kundërshtimin e verdiktit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

BALLKAN / 19 September 2026, 22:07

Nga Kosova në diasporë, shqiptarët protestojnë në Koln kundër vendimit të Speciales

BALLKAN / 19 September 2026, 21:53

Negociatat me BE-në, Mali i Zi përballet me pengesa për mbylljen e kapitujve

BALLKAN / 19 September 2026, 21:37

Nata e katërt e protestave në Prishtinë kundër aktgjykimit të Speciales

BALLKAN / 19 September 2026, 20:21

Nisma kundër Ligjit për Specialen pritet javën e ardhshme, PDK mbledh nënshkrimet

BALLKAN / 19 September 2026, 15:59

Virusi i Nilit Perëndimor në Kosovë, shkon në dy numri i viktimave

BALLKAN / 19 September 2026, 14:58

Pas 27 vitesh pritjeje/ ADN-ja identifikon tri viktimat të "Grupit të Intelektualëve"

BALLKAN / 19 September 2026, 11:23

Thirrjet për mbylljen e Speciales, vjen përgjigjja nga Haga: Mandati i Zyrës së Prokurorit të Specializuar vazhdon derisa...

BALLKAN / 19 September 2026, 10:51

Von der Leyen shmang Serbinë dhe Bosnjën gjatë turit në Ballkan, zgjedhjet dhe përplasjet e fundit me Beogradin në fokus

BALLKAN / 19 September 2026, 09:25

BALLKAN / 18 September 2026, 22:47

[Greqia plan për ripopullimin e
Çamërisë/ 10 mijë € për
familjet që pranojnë të
shpërngulen në këto zona](#)

[VIDEO/ Dënimi i ish-krerëve
të UÇK-së, djemtë e Thaçit,
Krasniqit dhe Veselit në
protestën e Prishtinës](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.